



Dep. DPK  
 Nr. Prot. 03-03/878/17  
 Br. Prot. 03-03/878/17  
 Prot No. 03-03/878/17  
 Nr. i faq. 02  
 Data 30.03.2017  
 Broj stranica 02  
 Date 30.03.2017  
 Nr. pages 02

# Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATË/A:	29.03.2017
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-803/17
PËR/ZA/TO:	z. Muhadin HALILI, Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Shtimes
CC:	z. Naim ISMAJLI, Kryetar i Komunës së Shtimes
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, <i>[Signature]</i> Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Ndërtimi i Shkollës Fillore në Muzeqinë në Komunën e Shtimes "

*I nderuar z. HALILI,*

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Ndërtimi i Shkollës Fillore në Muzeqinë në Komunën e Shtimes ", me numër të prokurimi: 617-17-806-511, me nr. të brendshëm: 617-2017-023-511, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

## OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Ndërtimi i Shkollës Fillore në Muzeqinë në Komunën e Shtimes ", me numër të prokurimi: 617-17-806-511, me nr. të brendshëm: 617-2017-023-511, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04/L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

## *Arsyetimi*

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), me datë 21.03.2017, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-803/17*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "*Ndërtimi i Shkollës Fillore në Muzeqinë në Komunën e Shtimes*", me numër të prokurimi: *617-17-806-511*, me nr. të brendshëm: *617-2017-023-511*, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Shtimes.

Agjencia, me datë 22.03.2017 ka paraqitur kërkesën për dokumentacion, pranë Autoritetit Kontraktues, ku ka kërkuar dokumentacionin përkatës para hapjes së tenderëve. Autoriteti i ka vënë në dispozicion Agjencisë dokumentacionin e kërkuar dhe të njëjtin pasi e ka shqyrtuar Agjencia ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit e cila është përgatitur nga ana e Autoritetit Kontraktues, tek rubrika 9.1 dhe 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale tek pika 3 është kërkuar që "**Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar kontrata, gjatë tri viteve të fundit 2014-2015-2016 në lëmin e ndërtimit dhe punëve të ngjashme, me Institucione Publike**" kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se është diskriminuese dhe kufizon konkurrencën e lire në mesin e Operatorëve Ekonomik.

Sipas Legjislacionit në fuqi për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues mundet të kërkojë kontrata dhe referenca për furnizime, shërbime dhe punë që ka realizuar Operatori Ekonomik me Institucionet Publike, Misionet Ndërkombëtare dhe Kompani Private, mirëpo nuk është e lejuar që të kërkohen kontrata apo referenca vetëm me Institucionet Publike. "**Sipas Legjislacionit në fuqi për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues mundet të kërkojë një listë që specifikon secilin nga projektet punuese të OE dhe aktiviteteteve të ndërtimit të kryera nga OE në 3 vitet e fundit të përcjellur me certifikatë të ekzekutimit të mirë që tregojnë vlerën, datën dhe llojin dhe vendin e projektit punues dhe/ose aktiviteteteve të ndërtimit/ certifikata e pranimit**".

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi 69 Aftësitë Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr materialin tenderik.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

*Me respekt !*